



PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Trupi Gjykses në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*, pasi shqyrtoi me kujdes parashtrimet e palëve, lëshoi Urdhër mbi Zhvillimin e Gjykimit, që trajton sjelljen në sallën e gjyqit gjatë gjykimit, procesin e nxjerrjes së materialeve, paraqitjen dhe pranimin e provave, kalendarin, pyetjet e dëshmitarëve nga palët dhe aspekte të tjera të nevojshme për garantimin e një procesi gjyqësor të drejtë dhe të shpejtë.

Në Urdhër, Trupi Gjykses rikujton palët të respektojnë karakterin publik të procesit dhe thekson se seancat private duhet të kërkohen veç kur është rreptësisht e domosdoshme. Palëve u kërkohet të dorëzojnë të gjitha parashtrimet me shkrim si dokumente publike dhe t'i kufizojnë aspektet konfidenciale sa më shumë të jetë e mundur.

Sa i takon autenticitetit dhe pranueshmërisë së provave, Trupi Gjykses thekson se është përgjegjësi e palëve të japin informacion lidhur me origjinën e provave materiale si dhe hapat që kanë ndërmarrë për verifikimin e informacionit. Pra, Trupi Gjykses inkurajon palët t'i caktojnë vetes një standard të lartë kur të vlerësojnë provat që synojnë të përdorin gjatë gjykimit.

Urdhrit mund t'i bëhen ndryshime në të ardhmen nga Trupi Gjykses, kur është e nevojshme, në varësi të zhvillimit të gjykimit. Dokumenti është publikuar në faqen e internetit të DHSK-së.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Trupi Gjykses i miratoi pjesërisht kërkesën e Mbrojtjes për apelimin e disa pjesëve të vendimit të tij për të pranuar si prova intervistat e z. Shala për TPNJ-në në 2005 dhe 2007, si dhe intervistat me autoritetet belge në 2016 dhe 2019. Në veçanti, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e z. Shala për apelimin e konstatimit se ai ishte informuar mjaftueshëm lidhur me natyrën e dyshimit kundër tij kur i dha ato intervista, dhe nëse ishte informuar mjaftueshëm kur hoqi dorë nga e drejta për avokat në ato raste.

Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, është publikuar version i redaktuar publik i aktgjykimit dhe gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

Në çështjen gjyqësore *Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj*, Paneli i Apelit do të shqiptojë aktgjykimin e apelit të enjten, 2 shkurt 2023, në orën 14:00. Seanca mund të përcillet në tri gjuhët e gjykatës përmes faqes zyrtare të internetit, me një vonesë të shkurtër, ose nga galeria e publikut.

Ju lutem kini parasysh se nevojitet regjistrim paraprak për të ndjekur shqiptimin e aktgjykimit të apelit, nga galeria e publikut. Afati për regjistrimin paraprak është të martën, 31 janar, në orën 16:00.





Në mënyrë që informimi javor të mos përkojë me kohën e shqiptimit të aktgjykimit nga Dhoma e Apelit, informimi javor javën e ardhshme do të mbahet në orën 4:30 të pasdites. Gazetarët mund të marrin pjesë përmes platformës *Zoom* ose fizikisht në sallën e medias në DHSK. Ju lutem, informoni ekipin për informim dhe komunikim me publikun nëse dëshironi ta ndiqni informimin javor nga salla e medias.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

